



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERVBAL^{1 2} (i përmbledhur)

Tiranë, më 30.06.2020, ora 15.00

Drejton mbledhjen Vitore Tusha – Zëvendëskryetare e Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Diskutime dhe vlerësime në lidhje me rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecies në Opinionin nr. 978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” për sa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
2. Të tjera që lidhen me vijimësinë e përgatitjes së çështjeve të shortuara.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|--------------------|
| 1. Vitore Tusha | (zëvendëskryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |
| 8. Arjan Qafa | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika , shkronja “d”, neni 232, pika 2, neni 242 shkronja “e”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Bashkëlidhur procesverbalit, për qëllime të njohjes nga kushdo i interesuar, gjenden projektvendimet me relacionet përkatëse të cilat janë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

9. Marsida Xhaferllari

(anëtare zëvendësuese)

10. Bilbil Mete

(anëtar zëvendësues)

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, sipas parashikimeve të nenit 233, pika 1, të ligjit nr. 115/2016:

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, dhe **Katrin Treska** përfaqësues të Presidentit të Republikës
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Marrin pjesë, si të ftuar, edhe përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED-së:

1. **Agnes Bernard**, drejtuese e misionit EURALIUS
2. **Aulona Hazbiu**, eksperte e EURALIUS
3. **Michelle Lakomy**, këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT
4. **Xhoana Kovaçi**, menaxhere programi për të drejtat e viktimave të krimit pranë OPDAT.

HAPET MBLEDHJA – ora 15:05

Zëvendëskryetarja e Këshillit, Vitore Tusha, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve, anëtarëve zëvendësues të Këshillit dhe të ftuarve.

Zëvendëskryetarja e Këshillit, Vitore Tusha, informon se janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit, me përjashtim të Kryetarit, duke bërë të ditur se zoti Dvorani i është drejtuar personalisht, në cilësinë e zëvendëskryetares dhe po ashtu të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli, duke prezantuar arsyet për mosthirrjen e mbledhjes nga ana e tij dhe duke kërkuar, në mënyrë të shprehur, që të vijohet, në përputhje me kompetencat që përcakton ligji, me thirrjen e mbledhjes, me qëllim që të mos vonohet procedura e vlerësimit të kandidatëve për vakancat që tashmë, Këshilli i ka gati prej një periudhe goxha të gjatë. Në vijim është proceduar me thirrjen e mbledhjes, duke lajmëruar edhe zotin Dvorani, i cili ka paraqitur një shkresë me *e-mail*, të cilën secili nga ju e ka mbi tavolinë, përmes së cilës ka informuar se ka dijeni për datën, orën dhe rendin e ditës me të cilën është thirrur mbledhja, si dhe ka parashtruar që paqartësia e situatës juridike në të cilën ai ndodhet tashmë, pasi akoma nuk i është komunikuar vendimi i arsyetuar nga KLGJ-ja, të mos bëhet pengesë për vijimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe shmangies së pretendimeve që kjo situatë mund të sjellë në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Këshillit. Mbi këtë bazë është thërritur kjo mbledhje, në përputhje me kompetencat që përcakton ligji, sipas të cilit, zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e Kryetarit në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme të Kryetarit.

Gjithashtu janë të pranishëm anëtarët zëvendësues, me përjashtim të zotit Nazmi Troka, i cili në komunikim telefonik ka informuar se për arsye të afateve të detyrueshme dhe të shkurtra ligjore që diktojnë masat e sigurimit, nuk do të jetë i pranishëm në këtë mbledhje, si dhe të zotit Nezir Gjoka, pasi KLP-ja ka pranuar kërkesës e tij për dorëheqje nga detyra e prokurorit; Avokati i Popullit; përfaqësuesit e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit. Nuk janë të pranishëm përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve.

Zonja Vitore Tusha fillon mbledhjen sipas rendit të ditës, që ju është bërë prezent me *e-mail* të gjithë anëtarëve.

Ajo thekson se ka vlerësuar caktimin e rendit të ditës me këto çështje, duke marrë shkas nga opinioni i përcjellë këto ditë nga Komisioni i Venecies dhe rekomandimet e posaçme që i adresohen këtij institucioni, megjithëse çështjet për dy vakancat e përkohshme janë bërë gati nga relatorët dhe presin vijimin e procedurave. Për shkak të ndikimit që sjellin rekomandimet në ecurinë e procedurave të këtij Këshilli mendon që, me gjithë rëndësinë që paraqesin të dyja problematikat e mësipërme, të vlerësohet, së pari, ndikimi i këtyre rekomandimeve në aktet normative të KED-së.

Megjithëse rekomandimet e Komisionit të Venecies përbëjnë një “ligj të butë” dhe nuk vendosin detyrime të mirëfillta, nisur edhe nga tradita e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, rekomandimet e Komisionit të Venecies kanë qenë udhërrëfyese ose baza mbi të cilën janë arsyetuar vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese.

Zonja Tusha parashtrohet se para sesa të fillojë shqyrtimi i pikave të njoftuara të rendit të ditës, të jetë e përfshirë në rendin e ditës si pikë e parë dhe të shqyrtohet në fillim të mbledhjes edhe miratimi i procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të kaluara të datave 3, 5, dhe 6 shkurt 2020, procesverbale të cilat u janë bërë anëtarëve me dije në adresat elektronike, përmes të cilave ky Këshill komunikon, duke qenë se këto çështje janë diskutuar në data të afërta dhe kanë pasur të njëjtën tematikë, që lidhet me ndryshimet në aktet normative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe ngre shqetësimin se nuk kanë marrë asnjë kopje të procesverbaleve, as të përmbledhura, gjatë kësaj kohe. Duke qenë se pjesë e këtyre procesverbaleve janë thëniet e tyre dhe në fakt procesverbali më shumë sesa thëniet e anëtarëve ka thëniet e të ftuarve, sepse kështu është konceptuar deri tani, qoftë edhe formalisht duhet të kenë një kopje të atyre, që pretendohet që janë thëniet e tyre. Unë nuk kam asnjë problem, por neve nuk ka ardhur kjo letër, ashtu siç ju kam vënë në dijeni ...

Ndërhyn zonja Tusha, duke saktësuar se bëhet fjalë për procesverbalet e dërguara në muajin shkurt, jo tani.

Erinda Balanca merr fjalën, duke theksuar se nuk kanë ardhur në asnjë moment. “Vetëm procesverbali i parë ka ardhur. Asnjë nga procesverbalet e tjera nuk na ka ardhur. Dhe në fakt kjo ishte një çështje që edhe unë e kisha për diskutim pasi dukej që edhe si vjet, përsëri Këshilli nuk po publikonte, brenda afateve të përcaktuara nga vetë rregullorja, procesverbalet e përmbledhura të cilat duhet të jenë të publikuara në faqet përkatëse. Këtë kisha.”

Vitore Tusha vë në dukje që nuk ka qenë në dijeni të kësaj çështjeje. “Do të më duhet pak kohë për t’u njohur me të gjitha procedurat dhe këtë do ta verifikoj menjëherë. Vlerësova që është

realizuar komunikimi, siç jam lajmëruar dhe prandaj jua shtrova. Ndërsa publikimi i tyre nuk mund të bëhej pa u miratuar.”

Erinda Ballanca merr fjalën dhe thekson se nuk është komunikuar as letra tjetër që zoti kryetar i ka drejtuar zonjës Tusha dhe anëtarëve. “Ne kemi marrë dijeni nga shtypi, po unë nuk u besoj më deklaratave të shtypit, për sa kohë, sigurisht, ndryshe mund të jenë ato që janë të publikuara në media dhe në shtyp dhe ndryshe janë komunikimet zyrtare midis anëtarëve. Nuk them se pse e ka vlerësuar zoti Dvorani të mos komunikojë me ne, nuk kam asnjë problem, por gjithsesi ju bëj me dije që unë nuk jam në dijeni të ndonjë shkresë zyrtare që ai ka dokumentuar në të kundërt, ju e dini, ne kemi pasur diskutime shumë të mëdha në Këshill që, çdo gjë e cila ka të bëjë me Këshillin dhe ushtrimin e mandatit brenda Këshillit, duhet të jetë sekret. Në kuptimin e frymës që ka qenë deri tani dhe të rregulloreve, të cilat janë të miratuara dhe në fuqi në rastin konkret, unë kisha merak, përveç atyre që thatë ju, të kisha në vëmendjen tuaj dhe një paraqitje që është bërë në Këshillin Kombëtar të Integritit nga ana e Kryetarit të KED-së, me disa qëndrime përkatëse, të cilat janë paraqitur si qëndrime të KED-së, por unë, me thënë të vërtetën, si person që jam në mbledhje, nuk i kam parë, nuk i kam konsultuar para apo konsideruar, sepse nuk ka pasur asnjë vendimmarrje në lidhje me këtë fakt. Është procesverbali i mbledhjes të datës 09.06.2020. Në këtë procesverbal ka dhe një qëndrim sigurisht të Kryetarit Dvorani, në lidhje me punën e KED-së dhe me zbatimin e detyrave të Shqipërisë në lidhje me integritimin evropian, ku përcaktohen dhe vendimmarrjet, edhe qëndrimet e tij, se përse KED-ja nuk ka punuar, përse nuk duhet të punojë dhe përse nuk duhet të mblidhet. Gjëra të cilat, në gjykimin tim, nuk kanë qenë asnjëherë në shqyrtim ose ndoshta kanë qenë komunikime me e-mail midis jush, nuk e di! Një kopje të këtij procesverbali, i cili është online, i publikuar në Kuvend. Unë kam dy kopje, mund t’jua paraqes. Një kopje ta mbajë sekretaria për t’ua shpërndarë edhe juve. E kisha me, do të doja që ta kishim në vëmendje edhe këtë si një qëndrim në emër të Këshillit, i bërë në Këshillin Kombëtar të Integritit Evropian.”

Vitore Tusha në lidhje me kërkesën për njohje me shkresën e datës 23 qershor, që i është adresuar asaj dhe anëtarëve nga Kryetari, vë në dukje që mund ta vërë në dispozicion në çdo moment. Ndërsa lidhur me qëndrimin që Kryetari z. Dvorani ka mbajtur si përfaqësues i këtij Këshilli, nuk mendon që duhet të përfshihet në këtë diskutim. Gjithashtu, shton se KED-ja, e përfaqësuar nga znj. Papajorgji, ka marrë pjesë në raundin e takimeve *online*, që ishte planifikuar nga nënkomiteti i Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë të BE-së dhe ka dhënë përgjigjet që janë konsultuar e vlerësuar së bashku, për pyetjet e adresuara në lidhje me KED-në. Gjithsesi, këto çështje, që lidhen me qëndrimet që ka mbajtur Kryetari nuk i përkasin rendit të ditës dhe thekson se nuk është i rëndësishëm fokusimi në këtë drejtim, por ecja përpara.

Erinda Ballanca merr fjalën duke theksuar se nuk ka asnjë problem dhe mendon që anëtarët e Këshillit të kenë dijeni.

Vitore Tusha sqaron se është në dijeni dhe do t’ua përcjellë.

Erinda Ballanca thekson se nuk ka asnjë problem dhe se personalisht kam qenë pjesë e
(nuk dëgjohet një fjalë)

Vitore Tusha sqaron se është janë dorëzuar disa nga materialet, është në dijeni, ka parë edhe përgjigjet, por sot nuk janë mbledhur për të analizuar këtë gjë. Në qoftë se ka diferenca ose komente, siç u tha tej asaj që ka ndodhur, ajo mendon se nuk i përket kësaj çështje për të cilën janë mbledhur. “Ne jemi mbledhur jo për të analizuar veprimtarinë e titullarit, por për të vijuar mbledhjen e thirrur. Ky është thelbi i asaj çka unë mendoj se duhet të veprojmë dhe dua të gjej mirëkuptim.”

Erinda Ballanca merr fjalën duke theksuar se është shumë dakord, por arsyeja pse e sjell në vëmendje të Këshillit është “se ka thënë qëndrimin për moszhvillimin për vendim për të mos thirrur mbledhjet e Këshillit, vendimmarrje që besoj duhet të ishte vendimmarrje kolektive, për të thënë faktin që ka faktorë të jashtëm.. (nuk kuptohet një fjalë), sepse nuk i dihet mandati im çfarë statusi do ketë. Në gjykimin tim nuk ka të bëjë me ecurinë e gjithë punës së Këshillit. Asnjëri prej nesh nuk mundet që të ... prej jush që jeni anëtarë, se unë nuk jam anëtare të vendos të mos e thërras Këshillin për çështje të veta personale. Kjo është një arsye që ju sigurisht mund ta vlerësoni ose jo, nuk kam asnjë lloj problemi.”

Vitore Tusha kalon në çështjen e parë të rendit të ditës.

Marsida Xhaferllari e merr fjalën duke thënë “Lidhur me kërkesën për procesverbalet, ashtu siç ju e thatë, ne me rregullat që kemi ndryshuar tek organizimi dhe funksionimi i KED-së, kemi parashikuar vendimin që çështja e parë automatike në rendin e ditës do të jetë shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve. Kështu që, unë e mirëkuptoj faktin që rendi i ditës nuk e ka si pikë më vete, por duke mbajtur në konsideratë faktin se publikimi i shkurtimit të procesverbalit është një çështje që është vënë në dukje si e metë që duhet riparuar nga Komisioni i Venecies, mendoj se pavarësisht se është një çështje automatike në vijim të rendit të ditës duhet të jetë e përfshirë në mënyrë të shprehur, e para. E dyta, në kushtet që Avokatja e Popullit ngre, paraqet, vë në dijeni faktin që nuk ka marrë dijeni dhe nuk i janë përcjellë procesverbalet, me përjashtim të procesverbalit të parë, ndoshta do të ishte mirë besoj të konfirmojmë nëse ka ndonjë tjetër këtu në tryezë që, sipas Rregullores, duhet t’i njoftohet procesverbali dhe nuk i është njoftuar dhe pas kësaj, këtyre personave që pretendojnë se nuk kanë marrë njoftim t’u niset menjëherë, që sot, mundësisht edhe tani. Mund të lemë një afat të shkurtër, 2-3 apo 4 ditë them unë, në vlerësim të Këshillit, që të konfirmojmë në heshtje ose të bëjmë komentet me qëllim që të mos vonohemi më tej për publikimin e këtyre procesverbaleve që nuk janë publikuar qoftë dhe për të dhënë mesazhin që do e kemi kujdes këtë çështje. Së fundmi, për sa i takon shqetësimin që ngre Avokatja e Popullit, unë besoj se kjo mund të jetë një çështje në kuadër të diskutimit që do të bëhet si pikë e parë e rendit të ditës. Mund të ngrihet edhe ky si shqetësim që deri ku shkojnë tagrat e kryetarit dhe zëvendëskryetarit në rastin konkret në përfaqësimin me të tretët të KED-së, thjesht për të saktësuar një çështje. Unë nuk e di fare

qëndrimin që është mbajtur, thjesht po e them në parim si shqetësim meqë e ngriti Avokatja e Popullit.”

Këshilli si çështje të parë të rendit të ditës ka rënë dakord që të shqyrtohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 3, 5 dhe 6 shkurt 2020.

Anëtarët diskutojnë në lidhje me faktin e prezantuar nga Avokatja e Popullit për mosnjohimin e procesverbaleve të mbledhjeve nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 të Këshillit dhe ranë dakord që procesverbalet e mbledhjeve t’i dërgohen Avokatit të Popullit dhe të ftuarve, nëse ata nuk kanë dijeni, si dhe miratimi i tyre të bëhet në mbledhjen pasardhëse.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vë në dukje se Komisioni i Venecies në Opinionin e tij të datës 19 qershor 2020, përmban fakte, konstatime, vlerësime të thelluara dhe ka disa rekomandime. Këto rekomandime për Këshillin janë të dyllshme, qoftë të karakterit rregullator, që kërkon patjetër ndryshimin e disa akteve nënligjore të KED-së, qoftë dhe të karakterit administrativ që duhet mbahen parasysh nga KED-ja përgjatë veprimtarisë së tij të mëtejshme. Në këtë mënyrë, grupi i punës që ngrihet për hartimin e projektakteve rregullatore në zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Venecies, duhet të nisë nga puna menjëherë dhe t’ia propozojë Këshillit sa më parë për vendimmarrje. Ndërkohë, KED-ja, pas kësaj çështjeje, të vijojë me shqyrtimin dhe verifikimin pa vonesë të kandidatave për të tria vendet vakante.

Saida Dollani pyet nëse është hera e parë që nuk merret procesverbalin apo ka ndodhur edhe herë tjetër.

Bledar Dervishaj e rimerr fjalën duke saktësuar se kjo është hera e parë që nuk e marrin procesverbalin, por në vlerësimin e tij vonesa ndoshta ka të bëjë me faktin se në këto procesverbale janë diskutuar pikërisht ato propozime që sot Venecia i ka kthyer prapë edhe njëherë nga e para për t’u shqyrtuar nga KED-ja. “Ato (procesverbalet) duhet të zbardhen, të miratohen në Këshill në mbledhjen e radhës, të publikohen, duke vazhduar sipas rregullave që Këshilli vet ka vendosur. Edhe po na erdhën sot, ne për një orë ju kthejmë përgjigje.”

Erinda Ballanca e merr fjalën duke vënë në dukje se nuk kanë marrë as kopje të rregulloreve. “Rreth rregulloreve të reja unë pyeta edhe zonjën Xhaferllari nëse ju kishin ardhur juve nga mbledhja e kaluar dhe, me sa duket, juve ju kanë ardhur, mua jo, as ato. Sepse në mbledhjen e fundit, në njoftimin e bërë publik për mbledhjen e fundit të datës 6, thuhej që brenda një muaji Kryetari do të përgatisë një variant përfundimtar të rregulloreve, me gjithë ndryshimet që janë miratuar në këto mbledhje dhe ne as ai tekst final nuk na ka ardhur dhe ndoshta ka pasur ndonjë ndryshim. Një nga arsyt mund të jetë se qëndrimi apo leximi i rregulloreve, së dyti, mund të jetë më restriktiv dhe mund të jetë një punë e Këshillit që mund të thotë nuk do t’i dërgojë me tek të ftuarit apo tek Avokati i Popullit dhe prandaj e ngre, se mund të ketë qenë dhe kjo për hir të së vërtetës.

Disa nga anëtarët e Këshillit u shprehën se rregulloret me ndryshimet janë të publikuara në faqen zyrtare të KED-së dhe në Fletoren Zyrtare të datës 11 shkurt.

Erinda Ballanca e merr fjalën duke theksuar se “ nëse miratohet një tekst me ndryshimet në gjykimin tim ndryshimi duhet të silltet në Këshill, teksti i ndryshuar. Ne kjo gjë nuk na ka ardhur, mund të jetë anashkaluar kjo fazë edhe si çështje vullneti, nuk kam asnjë problem. Nuk kam arsye të mendoj se nuk më kishin ardhur, kur më kanë ardhur në çdo mbledhje më parë. Kanë ndodhur dhe diskutime të tjera, kemi pasur dhe problematika të tjera që ndryshe është marrë vendimi në Këshill dhe ndryshe janë zbardhur. Kjo gjë na ka ndodhur, se s’është se s’na ka ndodhur, prandaj e kemi pasur si një problem dhe kryesisht ka ndodhur pikërisht me natyrën e procesverbaleve. Sepse qëndrimi i Këshillit ka qenë se kur mbledhjet nuk diskutojnë emra ose procedura që kanë ndikim në verifikime individuale, procesverbali do të miratohet i plotë, sepse asnjë qëndrim nuk ka lidhje me një kandidaturë të përcaktuar, për të qenë i fshehur. Pavarësisht kësaj, në zbardhjen që është bërë kësaj vendimmarrje këshilli, ka rezultuar që dhe ato procesverbale janë bërë të përmbledhura. Unë mbaj mend që ne kemi ngritur një grup pune në KED-në e parë e që grupi i punës ka qenë Këshilli. Nuk arriti ndonjë rezultat për përgatitjen e rregulloreve. Kjo ishte më tepër për t’u vënë në dijeni. Për sa i përket fazës në të cilën ndodhet shqyrtimi i çështjes së ngritur nga Avokati i Popullit në Gjykatën Administrative kundër Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për këto ndryshime, mund t’ju them se mbledhja për herë të parë duhet të jetë seancë me pesë gjyqtarë. Deri tani çështja ka qenë në procedurë përgatitore, sepse kanë dhënë dorëheqjen disa gjyqtarë për çështje konflikti interesi e të tjera dhe ditën e enjte do të jetë seanca e parë në të cilën do të zhvillohet procesi. Unë në fakt e kam treguar vullnetin tim, i jam drejtuar disa herë këtij Këshilli, që ato qëndrime që unë kisha të merreshin në konsideratë, sepse nuk do të dëshiroja të kishim një konflikt gjyqësor apo të kishte eventualisht, në gjykimin tim, një vendim gjyqësor në lidhje me pozicionin tonë brenda Këshillit. Unë i mbetem atij qëndrimi dhe jam e gatshme, për sa kohë që këto gjetje apo çështje do të adresohen dhe në masën që do të adresohen edhe sikur të jenë vetëm këto, në fakt këto janë ato më thelbësore, unë mendoj se nuk ka arsye që ne të vazhdojmë një proces gjyqësor të kemi një konflikt nëse do të adresohen çështjet e Komisionit të Venecias.”

Bledar Dervishaj kërkon dhe rimer fjalën. Për të qenë të saktë, më duhet të evidentoj se po këqyrja postën elektronike këtu në telefon dhe më rezulton se procesverbalet janë dërguar një pjesë për komente. “Nga që ka kaluar një kohë e gjatë dhe jemi në zhvillim e sipër të gjërave të tjera. Ne kemi dhënë koment për dy procesverbale dhe i kemi kthyer përgjigje zotit Dvorani se nuk kemi komente për përmbledhjen e procesverbaleve të dërguara. Me sa më rezultojnë këto janë dy procesverbalet 3, 4. Nuk e di tani cila është radha e tyre, cilat na kanë ardhur, por nëse vendosni të na i ridërgoni, ne për një orë, dy orë do të kthejmë përgjigje sërish.”

Erinda Ballanca merr fjalën duke theksuar se Këshilli ka ngarkuar Kryetarin që brenda një afati njëmuor, me mbështetjen e këshilltarëve ligjorë, të përgatiste dokumentin e projektregullores.

Vitore Tusha vë në dukje se ka dijeni për projektregulloren: puna ka filluar, por nuk është përfunduar.

Mimoza Arbi merr fjalën duke thënë se pasi opinioni përfundimtar i Komisionit të Venecies mbërriti në Kuvendin e Shqipëri, Shërbimi për Marrëdhëniet me Jashtë e çoi për përkthim zyrtar, kopje e të cilit është vunë në dispozicion. “Edhe Kuvendi do të reflektojë një rekomandim që ka lënë Komisioni Venecies në lidhje me Kuvendin, në rolin e tij legjislativ, për përmirësimin e kuadrit kushtetues dhe ligjor. Ndërsa për detyrat e lëna për KED-në, për rekomandimet e lëna për përmirësimin e kuadrit nënligjor mbi bazën e të cilit funksionon Këshilli jeni ju, për rregullimin e tyre referuar pikërisht këtyre rekomandimeve. Në lidhje me shqetësimin për përkthimin, unë do ta përcjell te drejtoria përkatëse dhe në momentin e rregullimit të materialit do t’jua dërgojmë përsëri. Ne kemi kontaktuar me një përkthyes zyrtar. Nuk e di kush është ajo, se natyrisht është shërbimi tjetër që ka kontaktuar. Është sjellë përkthimi sot dhe unë ia kam nisur KED-së, sipas porosisë së kryetarit të Komisionit të Ligjeve. Nëse ai ka disa probleme, ne do të sjellim draftin e riparë nga përkthyesja zyrtare dhe do ta vëmë në dispozicion KED-së për të mos pasur një konvergjençë në kuptimin e asaj çka është përkthyer ose e asaj çka Komisioni i Venecies rekomandon realisht për organet përkatëse, qoftë për Kuvendin, qoftë për KED-në apo për strukturat e tjera të përmendura në opinion. I urojmë punë të mbarë KED-së dhe presim sa më parë plotësimin e vakancës, që është shqetësimi kryesor.”

Anëtarë e Këshillit vijuan me diskutimin për rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecies në Opinionin nr. 978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” për sa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët u shprehën se ishin në dijeni të këtyre rekomandimeve, si dhe, veçanërisht, të rëndësisë që rekomandimet e përcjella kanë për vijimin e funksionimit të veprimtarisë së KED-së, si dhe në lidhje me domosdoshmërinë që këto rekomandime të reflektohen në aktet normative të këtij institucioni.

Vitore Tusha vë në dukje se ka pasur disa komunikime me krerët e institucioneve kushtetuese të emërtesës së gjyqtarëve kushtetues, të cilët mbështesin veprimtarinë e KED-së në lidhje me implementimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecies në aktet normative në drejtim të zbatimit të Kushtetutës dhe ligjeve nga ky institucion. Reflektimi i këtyre rekomandimeve prek disa norma të akteve normative. Ajo propozon ta hedhin në votim, të respektohet procedura dhe pastaj të merren me veprimet që do të duhet të ndjekin në këtë drejtim, ngritjen e një grupi pune, e të propozimeve konkrete.

Anëtarët e Këshillit ranë dakord duke miratuar, sipas rendit të ditës, që rekomandimet e Komisionit të Venecies të gjejnë reflektim në aktet normative të KED-së.

Ata, gjithashtu, diskutuan dhe ranë dakord për ngritjen e një grupi pune për këtë qëllim, të përbërë nga zonja Saida Dollani, anëtare, dhe zonja Marsida Xhaferllari, anëtare zëvendësuese. Të dyja anëtarët pranuan detyrën dhe shprehën angazhimin e tyre të plotë për përmbushjen sa më shpejt të kësaj detyre, në mënyrë që procesi të eci përpara.

Vitore Tusha kalon në pikën e dytë të rendit të ditës. Ajo informon në lidhje me fazën e përgatitjes së tri çështjeve të vakancave, që priten të shqyrtohen. Në lidhje me dy vakancat e përkohshme, që të dy relatorët si znj. Marku dhe znj. Dollani kanë lajmëruar me shkrim, në përputhje me procedurën, që dosjet janë përgatitur ka mbetur vetëm komunikimi i relacioneve të kandidatëve. Kjo për arsye se relacioni duhet të përmbajë edhe datën e zhvillimit të mbledhjes në lidhje me verifikimin e kushteve ligjore të kandidaturave. “Ky hap procedural do të bëhet menjëherë sapo ne të caktojmë datën e mbledhjes dhe pasi të kemi miratuar ndryshimet, sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecies në aktet normative. Këtë do e vendosim së bashku.

Ndërsa lidhur me vakancën tjetër, që është plotësuese e mandatit të z. Muçi, deri tani janë dërguar shkresat standarde të të gjitha institucioneve. Mendoj se periudha e Covid-19 ka bërë që disa institucione të mos përgjigjen, duke ndikuar në vijimësinë e procesit në lidhje me komunikimet me kandidatët për gjetjet.

Erinda Ballanca e merr fjalën për të shpjeguar se ndoshta për çështjen, nuk ka një rregull. “Këto relacione, pasi i lexojmë nuk janë miratuar me një vendim të KED që të jenë strikte çfarë duhet të përmbajnë, pak a shumë ideja është, nuk është se formati është si një akt që të jetë bashkëngjitur, në këtë sens gjithsesi mund t’i dërgohet kandidatit duke i thënë se një mbledhje do të caktohet brenda dy javëve të para të korrikut apo me telefon do ju njoftojmë se kur do jetë mbledhja. E rëndësishme është që të jepet një afat, sepse ata kanë mundësi gjithmonë që të mbajnë një qëndrim në lidhje me gjetjet edhe në momentin përfundimtar. Kjo ka qenë procedura që kemi ndjekur dhe qëllimi është sa më shumë tu jepni mundësi kandidatëve që të paraqesin elemente, dokumente dhe prova për të vërtetuar të kundërtën nëse ka pasur gjetje negative. Kështu që, kjo është një gjë që eventualisht mund të jetë e zgjidhshme.”

Bledar Dervishaj e merr fjalën duke theksuar se, nga sa u citua rezulton se, për dy vakanca kanë ardhur të gjitha informacionet, ndërkohë që për një vakancë nuk kanë ardhur tërësisht informacionet e kërkuara nga institucionet e treta. “Në qoftë se Këshilli ka pengesë për konfirmime, apo shkresa të institucioneve të ndryshme që ende nuk i kanë sjellë, nëse nevojitet mbështetja e Presidentit apo Kuvendit nuk do të mungojë. Nuk besoj se ka organ mbi Kuvendin, prej të cilit varen të gjithë, që të pengojë punën. Mbështetja për KED, u diskutua edhe sot në takim midis Kreut të Shtetit dhe Kryetarit të Kuvendit, ku u dakordësua për një mbështetje maksimale për veprimtarinë e Këshillit. Nëse ka institucione të cilat hezitojnë të kthejnë përgjigje, apo vonojnë përgjigjet për shkak të situatës Covid, për të cilat ne si info do i marrim këtu, se cilat janë ato institucione, që ne do ti bëjmë me shkresë. Kuvendi disa prej tyre i ka në varësi, disa janë në varësi të Këshillit të Ministrave, gjithmonë nëse ka. Nuk besoj të ketë institucion që të marre riskun të pengojë këtë proces”.

Miranda Andoni e merr fjalën duke vënë në dukje që ka një dorëheqje të një kandidati. “Nuk besoj se ka nevojë për kohë, mund të përgatitet menjëherë vendim, projektvendimi për këtë rast, ndërsa për rastet e tjera jemi duke pritur përgjigjet”.

Bledar Dervishaj e rimerr fjalën duke theksuar se për vakancën e tretë, që i takon Presidentit, se dy të parat sipas relatimit janë gati të mbaruara, nëse relatorja do të evidentojë se cilat institucione të ndryshme nuk kanë kthyer përgjigje. Nëse ju e shikoni të arsyeshme që t’i drejtoheni edhe një herë me shpresë për kujtesë këtyre institucioneve, për dijeni mund të vendosni dhe Institucionin e Presidentit apo Kuvendin dhe ne do të angazhohemi që të gjitha këto përgjigje të vinë sa më shpejt. Do japim çdo mbështetje të nevojshme në këtë kuadër. Mjafton një raport nga këshilltarët që ta dimë dhe ne se cilat janë institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje.

Vitore Tusha pyet nëse zonja Agnes dhe zonja Michele kanë diçka për të thënë.

Agnes Bernhard e merr fjalën duke thënë se nuk ka asgjë specifike për të shtuar, por dëshiron të shpreh urimin e saj që ky proces të lëvizë, të ecë përpara për të siguruar funksionimin e duhur të Këshillit.

Michelle Lakomy falënderon duke vlerësuar se bashkëpunimi i zyrës së Presidentit me Kuvendin dhe me grupin e punës së ngritur do të jetë shumë rezultativ dhe do të realizojë me sukses zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Komisioni i Venecias.

Vitore Tusha falënderon të pranishmit duke njoftuar se mbledhja e radhës do të thirret sa më shpejt. Një përmbledhje e njoftimit për shtyp do t’iu komunikohet menjëherë, duke iu kërkuar një konfirmim të shpejtë.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 16:20

SEKRETARE

ZV/ KRYETARE

Ermelinda KADIU

Vitore TUSHA

Dorina DULAJ

Fabiola MUHAMETAJ

Vilma DOKUSHI

Elona KARDHIQI